



Planuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivery	09.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	7868	2022	115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.893/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave Në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbaitësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.893/2022 të datës 12.10.2022 të parashtruar nga ankuesi, me adresë Nr.23, Komuna e Istogut, kundër Vendimit me numër protokolli 30KA/2 të datës 19.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.893/2022 e datës 12.10.2022 e parashtruar nga ankuesi.
- II. **Shfuqizohet** Vendimi me numër protokolli 30KA/2 i datës 19.09.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. **Obligohet** Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 12.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6096/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.893/2022 në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 30KA/2 të datës 19.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimet ankimore së vendimi i goditur me ankesë është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimin e së Kaluarës së Tyre, Periudhën Provuese dhe Promovimin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 17.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa më 19.10.2022 ka pranuar përgjigjen se bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit në pajtim me dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.11.2022 me Vendimin me numër VK.Nr.161/2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune lidhur me ankesën A.nr.893/2022 të datës 12.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesa me numër të protokoll 6096/2022 të datës 12.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër protokoll 30.KA/2 të datës 19.09.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Konkurs i Brendshëm me numër protokoll 662 të datës 02.06.2022 i shpallur nga Shërbimit Korrektues i Kosovës; Rezultatet e vlerësimit të testit me shkrim lista e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë të datës 19.08.2022; Rezultatet e vlerësimit të intervistës me gojë për pozitën mbikëqyrës i lartë ku kandidati konsiderohet se ka kaluar testin e intervistës me gojë nëse ka arritur së paku 60 pikë të datës 31.08.2022; Ankesën nga ankuesi të datës 09.09.2022 drejtuar Komisionit për ankesa në SHKK; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.10.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 19.10.2022; Shkresën për përgjigjen e lëndës për ankesë me numër protokoll 6261/2022 të datës 17.10.2022; Kontratë Pune për Kohë të Caktuar nga MD/SHKK të datës 11.03.2019; Rekomandim për përtëritjen kontratës MD/SHKK të datës 05.03.2019; Vendim me numër protokoll 0529 të datës 11.05.2022; Vendim me numër protokoll 0529 të datës 11.05.2022; Vendim me numër protokoll 736 të datës 04.07.2022; Vendim me numër protokoll 0188 të datës 18.02.2022; Akt Emërimi të datës 07.06.2019; Kontratë pune për kohë të caktuar të datës 01.12.2010; Rekomandim për përtëritjen e kontratës të datës 11.04.2018; Vendim me numër protokoll 842 të datës 19.06.2019; Vendim me numër protokoll 774 të datës 12.07.2022; Lista e zyrtarëve që i kanë plotësuar kriteret për të ju nënshtruar testit me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i Lartë që do të mbahet me të datës 18.08.2022; Rezultatet e vlerësimit të testit me shkrim lista e kandidatëve që nuk e kanë kaluar testin me shkrim për pozitën Mbikëqyrës i lartë të datës 19.08.2022; Ftesë për intervistën me gojë për kandidatët që kanë kaluar testin për mbikëqyrës të lartë, intervista do të mbahet me datën 29.08.2022; Njoftim të gjithë kandidatët e pakënaqur me vlerësimin e testit me shkrim se mund të shohim testet e tyre me datë 24.08.2022 deri me datën 25.08.2022; Rezultat e vlerësimit të intervistës me gojë për pozitën mbikëqyrës i lartë; Rezultatet e renditjes përfundimtare të kandidatëve për pozitën mbikëqyrës i lartë pas të vlerësimit të pikëve te testit me shkrim dhe intervistës i datës 01.09.2022; Vendimin VK.Nr.161/2022 i datës 22.11.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe se çështja duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, SEPSE:

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 4 përcaktohet se: 1. *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...*" nga rrjedh se nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve*, dhe se ekziston kompetenca lëndore për trajtimin e kësaj çështje ankimore në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 16 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë administrimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Shërbimi Korrektues i Kosovës, më datë 02.06.2022 ka publikuar Konkursin për gradim me numër protokolli 629 për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, me numër reference MD/SHKK/003/01.06.2022, në të cilën pozitë ka aplikuar edhe ankuesi dhe si rrjedhojë ju kishte nënshtruar të gjitha fazave të procesit të gradimit, ku në testin me shkrim kishte rritur t'i mbledh 62.5 pikë, ndërsa në intervistë më gojë ishte vlerësuar me gjithsej 56.6 pikë, me ç' rast i njëjti nuk kishte arritur numrin e pikëve të mjaftueshme për tu shpallur kandidat fitues.

I pakënaqur me Listën përfundimtar të datës 01.09.2022 të kandidateve fitues për pozitën Mbikëqyrës i Lartë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, ankuesi brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 19 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, Kontrollimi i së Kaluarës së Tyre, Periudha Provuese dhe Promovim (*me tej referuar si: Udhëzimi Administrativ MD-Nr.02/2022*) ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin më numër protokolli 30KH/2 të datë 19.09.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Kundër Vendimit me numër protokolli 30KA/2 të datës 19.09.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor së vendimi i goditur me ankesë është nxjerr përmes shkeljes së dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022, duke theksuar së në këtë vendim nuk është shpjeguar situata faktike mbi të cilin është marrë vendimi sepse sipas të njëjtit përbërja e Komisionit Përzgjedhës ishte në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.02/2022, kështu i njëjti kërkon të anulohet Vendimi me numër protokolli 30KA/2 i datës 19.09.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Konkursi i brendshëm me numër protokolli 622 i datës 02.06.2022 dhe të detyrohet Shërbimi Korrektues i Kosovës që të rishpall konkurs të brendshëm për gradim për pozitën përkatëse të punës.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit analizoi aktin e goditur me ankesë, gjegjësisht Vendimin me numër protokolli 30KA/2 të datës 19.09.2022 të

Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe si rrjedhojë vlerësoj se i njëjti përmban të meta esenciale që pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit. Kjo për faktin se me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 48 përcaktohet se: 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Ndërsa me nenin 134 paragrafi 1 të të njëjtit ligj përcaktohet se: 1. Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë.

Në kuptim të dispozitave ligjore të cekura si me lartë Kolegji i Këshillit vlerëson se Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës, me rastin e shqyrtimit të ankesës nuk ka shqyrtuar pretendimet kryesore të ankuesit ngase refuzimi i ankesës është bërë vetëm mbi një konstatim të përgjithshëm dhe abstrakt duke theksuar se, citoj: "Komisioni ka konstatuar se në baze të vendimit nr.774 të datës 12.07.2022 është emëruar komisioni përzgjedhës për zhvillimin e kësaj procedure të gradimit, komisioni përzgjedhës ka qenë në pajtim me dispozitat e nenit 11 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 i datës 21.04.2022 për gradat e zyrtareve korrektues" ... "Komisioni Përzgjedhës sipas nenit 11 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022 për gradat e zyrtareve korrektues ka të përshirë një anëtar të grupit etnik si dhe të gjithë anëtarët janë në pozita më të larta së pozita mbikëqyrës i lartë, si dhe kandidati gjatë fazës së intervistës nuk ka paraqitur ankesë në përbërjen e Komisionit" i cili arsyetim në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit është i pamjaftueshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 1.3, 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase i njëjti nuk përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret si dhe shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palës.

Rrjedhimisht nga analizimi i vendimit të goditur me ankesë rezulton se Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave nuk ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit, për faktin se ankuesi në ankesën e tij në mënyrë konkrete pretendon se në përbërje të Komisionit Përzgjedhës nuk kishte asnjë anëtar të gjinisë femërore dhe se anëtarët e këtij komisioni nuk kishin grada me të larta se pozita që rekrutohej, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase organi publik, në rastin konkret Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës është i obliguar që t'i shqyrtoj të gjitha pretendimet ankimore të palës ankuese.

Me dispozitat e nenit 11 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.02/2022, përcaktohet se Komisioni Përzgjedhës themelohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm dhe përbëhet nga tre anëtarë, i cili do të përfshijë anëtar të grupeve etnike dhe barazisë gjinore, ku kryesuesi dhe njëri anëtarë i komisionit duhet të ketë së paku 1 (një) gradë më të lartë se grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, kurse anëtari i tretë i komisionit duhet të jetë nga njësia e burimeve njerëzore, ndërsa nga analizimi i vendimit të goditur me ankesë Kolegji i Këshillit vëren se Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave, edhe përkundër faktit se pretendimi kryesor i ankuesit ishte në këtë drejtim, nuk ishte lëshuar fare në

trajtimit e këtij pretendimi ankimor dhe rrjedhimisht konstatimin e përputhshmërisë se përbërjes se komisionit me këtë dispozitë ligjore.

Andaj, për sa me sipër dhe duke qenë se Vendimi me numër protokolli 30KA/2 i datës 19.09.2022 i Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe rrjedhimisht vlerësoi që kjo çështja ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj ankesën e ankuesit të datës 09.09.2022, të eliminoj shkeljet e konstatuar sipas këtij vendimi dhe të nxjerr akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Kështu që pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.893/2022

Aydyl Bekteshi


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Komisionit për Zgjidhjen e Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës (SHKK);
- Udhëheqësit të Personelit në SHKK; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

